



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**

*Qeveria - Vlada - Government*

*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës -*  
*Agjencia za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

# **Anketa e Ekonomive Bujqësore 2022**



Prishtinë, 2023





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës -*  
*Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

# **Anketa e Ekonomive Bujqësore 2022**



Prishtinë, 2023

Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)  
Data e botimit: Korrik, 2023  
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës  
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.  
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:  
<http://ask.rks-gov.net>

## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) realizon Anketën e Ekonomive Bujqësore (AEB) në baza vjetore, që nga vitit 2004. Ky është publikimi i tetë i realizimit të AEB-së sipas metodologjisë së harmonizuar me metodologjinë e Eurostatit (pyetësi, udhëzuesi, definicionet), e cila mundëson krahasueshmërinë ndërkombëtare të të dhënave.

Qëllimi i kësaj ankete është që të sigurohen të dhëna statistikore për sektorin e bujqësisë në Kosovë. Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore 2022, të prezantuara në këtë publikim, ofrojnë një burim të rëndësishëm të informatave mbi gjendjen e tanishme të bujqësisë në Kosovë (për periudhën referuese të anketës).

Në këtë publikim janë paraqitur rezultatet në formë përmbledhëse për shfrytëzimin e tokës bujqësore, kulturat bujqësore bimore (drithërat, bishtajoret, kulturat industriale, patatet, kulturat foragjere, perimet, pemët, vreshtat), prodhimtari bimore, blegtorinë dhe produktet blegtorale ( qumështi, produktet e qumështit, mishi, vezët, mjalti etj ), therja dhe shitja e kafshëve, inputet bujqësore (plehurat minerale, organike, pesticidet) dhe shpenzimet e fermës për periudhën referuese (31 Tetor 2021 -1 Nëntor 2022). Të dhënat e prezantuara janë kryesisht nga rezultatet e kësaj ankete, por ka edhe disa të dhëna nga burimet administrative (të dhënat e vreshtarisë) nga MBPZHR dhe nga Regjistrimi i Bujqësisë 2014.

### Publikimi është i përgatitur nga:

Bajrush Qevani - Drejtor i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit,  
Violeta Arifi-Gashi - Shefe e Divizionit të Statistikave të Bujqësisë,  
Selami Zylfiu - Zyrtar i Statistikave të Blegtorisë,  
Hasime Bytyqi - Zyrtare e Statistikave të Kulturave Bujqësore Bimore,  
Florid Bytyqi - Zyrtar i Statistikave të Blegtorisë,  
Servete Muriqi - Zyrtare e Lartë e Metodologjisë,

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet, lidhur me këtë publikim, janë të mirëseardhura.

### Falënderimet

ASK- ja falënderon të gjithë zyrtarët e tjerë të ASK-së, anketuesit dhe respondentët në terren për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë.

## Lista e shkurtesave

AEB	-	Anketa e Ekonomive Bujqësore
ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
EB	-	Ekonomi Bujqësore
BE	-	Bashkimi Evropian
AEShB	-	Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore
MBPZhR	-	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
RB	-	Regjistrimi i Bujqësisë 2014
RrDhKF	-	Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave
CAPI	-	Computer-assisted personal interviewing - Intervistë me ndihmën e kompjuterit

## Simbolet

:	-	Të dhënat nuk janë në dispozicion
0	-	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	-	Nuk aplikohet
Ha	-	Hektar
Ari	-	Ari
m <sup>2</sup>	-	Metër katror
Kg	-	Kilogram
T	-	Ton
€	-	Euro
%	-	Përqindje
≥	-	Më e madhe ose e barabartë

Në tabelat ku janë rrumbullakuar shifrat, deri në shifrën e fundit më të afërt, mund të ketë mospërputhje të lehtë të shumave të prezantuara.

## Përmbajtja

	Faqe
<b>1. Objektivat, metodologjia dhe fushëveprimi i anketës .....</b>	<b>9</b>
Tabela 1: Variablat dhe kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës të kulturat bujqësore bimore ....	10
Tabela 2: Numri i ekonomive bujqësore të zgjedhura në moster sipas madhësisë dhe rajoneve për kulturat bujqësore bimore.....	11
Tabela 3: Numri i ekonomive bujqësore të intervistuar sipas madhësisë së fermës dhe rajoneve për kulturat bujqësore bimore .....	11
Tabela 4: Variablat dhe kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës të blegtorisë .....	11
Tabela 5: Numri i ekonomive bujqësore të zgjedhura në mostër sipas madhësisë dhe rajoneve për sektorin e blegtorisë .....	12
Tabela 6: Numri i ekonomive bujqësore të intervistuar sipas madhësisë së fermës dhe rajoneve për blegtorinë .....	12
Tabela 7: Variablat dhe kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës për anketën ekonomike bujqësore.....	12
Tabela 8: Numri i ekonomive bujqësore të zgjedhura në mostër sipas madhësisë dhe rajoneve për anketën ekonomike bujqësore .....	13
Tabela 9: Numri i ekonomive bujqësore të intervistuar sipas madhësisë së fermës dhe rajoneve për ekonomike bujqësore.....	13
<b>2. Shfrytëzimi i tokës bujqësore .....</b>	<b>17</b>
Tabela 1.: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore .....	17
Tabela 2: Kulturat bujqësore në tokë të punueshme - ara, prodhimi dhe rendimenti.....	18
Tabela 3: Perime në tokë të punueshme - ara, sipërfaqja, prodhimi në fushë të hapur, serra, kopshte .....	21
Tabela 4: Sipërfaqja dhe prodhimi i perimeve në fushë të hapur, serra dhe kopshte .....	22
Tabela 5: Sipërfaqja dhe prodhimi me kulturave të dyta (pas korres së parë) .....	23
Tabela 6: Sipërfaqja e mbjellë me pemë, prodhimi dhe rendiment .....	23
Tabela 7: Sipërfaqja e mbjellë me vreshta, prodhimi dhe rendimenti.....	24
Tabela 8: Sipërfaqja e livadheve, kullosave dhe tokës së përbashkët , prodhimi dhe rendimenti .....	25
Tabela 9 : Sipërfaqja e ujitur .....	26
<b>3. Blegtoria.....</b>	<b>27</b>
Tabela 1: Fondi blegtoral (numri).....	27
Tabela 2: Numri i gjedheve sipas grup moshave, gjinisë dhe destinimit .....	28
Tabela 3 : Numri i gjedheve sipas grup moshave.....	28
Tabela 4: Numri i deleve sipas kategorive .....	31
Tabela 5: Numrit i dhive sipas kategorive .....	32
Tabela 6: Numri i derrave sipas peshës dhe destinimit .....	33
Tabela 7: Njëthundrakët.....	34

Tabela 8: Shpezë .....	34
Tabela 9: Koshere bletësh .....	35
Tabela 10 Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit .....	36
Tabela 10.1. Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit (vazhdim) .....	36
Tabela 11 Produktet e qumështit të përpunuara në EB dhe shfrytëzimi i tyre .....	38
Tabela 12 Kafshët e therura në EB dhe jashtë EB-së .....	40
Tabela 13 Prodhimi dhe shfrytëzimi i mishit dhe produkteve tjera blegtorale në EB.....	43
<b>4. Inputet bujqësore .....</b>	<b>48</b>
Tabela 1: Përdorimi i plehrave minerale në kulturat bujqësore .....	48
Tabela 2: Përdorimi i plehrave organike sipas grupit të kulturave bujqësore .....	48
Tabela 3: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore, në të cilën janë përdorur pesticidet .....	49
<b>5. Shpenzimet e fermës .....</b>	<b>50</b>
Tabela 1: Struktura e shpenzimeve në fermë .....	50



## 1. Objektivat, metodologjia dhe fushëveprimi i anketës

### 1.1. Objektivat dhe fushëveprimi i anketës

Objektivë e Anketës së Ekonomive Bujqësore 2022 është që të ofroj të dhëna mbi gjendjen e bujqësisë në Kosovë, shfrytëzimin e tokës bujqësore, kulturat bujqësore, blegtorinë dhe produktet blegtorale, imputet bujqësore (plehrat minerale, organike, pesticidet) dhe shpenzimet e fermës. Anketa synon që të ndihmoj në llogaritjen e nivelit të zhvillimit të sektorit të bujqësisë në Kosovë dhe të ofroj bazat për monitorimin e ardhshëm të trendëve në këtë sektor. Anketa e Ekonomive Bujqësore 2022 në teren është realizuar në 34 komunat e Republikës së Kosovës. Anketa nuk është realizuar në 4 komunat në veri të Republikës së Kosovës për arsye se Regjistrimi i Bujqësisë 2014 (RB) nuk është kryer në këtë pjesë dhe nuk kemi regjistër të ekonomive bujqësore nga RB 2014. Për katër komunat në veri ne kemi bërë një vlerësim duke u bazuar në të dhënat që i kemi pasur në dispozicion nga anketat e mëhershme në bujqësi në veçanti nga Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2013 (AESHB). Prandaj rezultatet e prezantuara në këtë publikim janë reprezentative për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Të dhënat janë paraqitur vetëm në nivel të Kosovës.

### 1.2. Korniza e Anketës së Ekonomive Bujqësore 2022

Si burim për dizajnimin e mostrës së Anketës së Ekonomive Bujqësore 2022 është shfrytëzuar Regjistrimi i Bujqësisë (RB) 2014. Regjistrimi i bujqësisë është kryer në nëntor 2014 në 34 komuna të Republikës së Kosovës. Edhe pse ishin bërë përgatitjet, Regjistrimi nuk ka mundur të kryhet në katër (4) komunat në veri të Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok), pasi që këto komuna refuzuan të marrin pjesë.

Prandaj, Regjistri i Ekonomive Bujqësore nga Regjistrimi i Bujqësisë 2014 përfshin vetëm Ekonomitë Bujqësore në 34 komuna të Republikës së Kosovës. Ky regjistër përmban të gjitha informacionet e nevojshme për dizajnimin e mostrës sipas standardeve të BE-së. Për përkufizimin e kornizës së mostrës është analizuar pragu – kufiri që është shfrytëzuar në Regjistrimin e Bujqësisë 2014. Analizat treguan se pragu i përdorur në RB 2014 mund të shërbejë edhe për qëllime të përkufizimit të kornizës së mostrës dhe nuk kishte nevojë për kritere shtesë.

#### Pragu

Në Regjistrimin e Bujqësisë 2014 janë përfshirë vetëm Ekonomitë Bujqësore, të cilat e kanë plotësuar të paktën një nga kriteret e mëposhtme dhe pragu i njëjtte është aplikuar dhe tek AEB 2022:

1. Ekonomia punon 10 ari (1 000 m<sup>2</sup>) ose më shumë tokë bujqësore të shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore;
2. Ekonomia prodhon perime, lule ose produkte të tjera bujqësore në serra për shitje;
3. Ekonomia mban një ose më shumë gjedhe ose kuaj;
4. Ekonomia mban të paktën 3 derra të rritur;
5. Ekonomia mban të paktën 4 krerë të rritur të deleve ose dhive dhe derrave së bashku;
6. Ekonomia mban të paktën 50 shpezë të rritura dhe lepuj femra së bashku;
7. Ekonomia mban të paktën 20 koshere bletësh;
8. Ekonomia prodhon kërpudha për shitje.

Agjencia e Statistikave të Kosovës gjate vitit 2022 ka bërë rritjen e madhësisë së mostrës së kësaj ankete me qëllim të rritjes së cilësisë së të dhënave dhe lehtësimit të grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu dizajnimi i mostrës së kësaj ankete është bërë ndaras si tri anketa. Dizajnimi i mostrës është bërë veçmas për Kulturat Bujqësore Bimore, Blegtorin dhe Anketën Ekonomike Bujqësore. Madhësia e mostrës për anketën e Kulturave Bujqësore Bimore ishte 6000 EB. Madhësia e mostrës për anketën e Blegtorisë ishte 3000 EB, ndërsa madhësia e mostrës për anketën Ekonomike Bujqësore ishte 800 EB. Disa EB kane qenë të përzgjedhura në të tri anketat e disa vetëm në dy anketa. Si përfundim madhësia e mostrës është 9800 EB.

### 1.3. Përcaktimi i dizajnit të mostrës për Kulturat Bujqësore Bimore

Për kulturat bujqësore bimore pasi janë bërë disa vlerësime si dhe llogaritje e gabimeve te mostrës për shumicën e variablave është vendosur të jetë 6000 ekonomi bujqësore. Dizajni i mostrës një fazore, ndërsa variablat që janë përdorur për krijimin e stratave janë Regjioni (7 regjione) si dhe numri i klasave (4 klasa), gjithsej 28 strata.

#### Madhësitë e klasave

Ekonomitë Bujqësore (EB) janë ndarë në katër (4) kategori, sipas madhësisë së klasave. EB-të e madhësisë 1 janë EB-të më të mëdha, ndërsa ato të madhësisë 2, 3 dhe 4 janë EB-të më të vogla. Tabelat në vijim paraqesin se cilat variabla janë marrë si bazë për definimin dhe përcaktimin e madhësisë së klasave.

**Tabela 1: Variablat dhe kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës te kulturat bujqësore bimore**

Variablat	Kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës		
	Madhësia e klasës 1	Madhësia e klasës 2	Madhësia e klasës 3
Toka e shfrytëzueshme bujqësore	≥ 2000 ari	≥ 1000 ari	≥ 200 ari
Toka e punueshme ( arat )	≥ 1000 ari	≥ 500 ari	≥ 200 ari
Drithëra kokërr	≥ 850 ari	≥ 250 ari	≥ 120 ari
Bishtajore kokërr	≥ 150 ari	≥ 100 ari	≥ 20 ari
Bimë industriale	≥ 200 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Patate	≥ 800 ari	≥ 200 ari	≥ 50 ari
Vreshta	≥ 500 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Kultura të tjera rrënjore	≥ 300 ari	≥ 150 ari	≥ 50 ari
Pemishte	≥ 500 ari	≥ 100 ari	≥ 30 ari
Serra	≥ 100 m <sup>2</sup>	≥ 50 m <sup>2</sup>	≥ 20 m <sup>2</sup>
Kulturave të përziera	≥ 300 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Pemët manore	≥ 100 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari
Lakra	≥ 250 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari
Speci	≥ 250 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Qepa	≥ 120 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari
Shalqiri dhe pjeperi	≥ 150 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari

Alokimi: Shpërndarja optimale është bërë duke përdorur tokën e shfrytëzuar bujqësore (TSHB) si ndryshore (variabel) ndihmëse për përcaktimin e numrit të ekonomive të përzgjedhura.

**Tabela 2: Numri i ekonomive bujqësore të zgjedhura në moster sipas madhësisë dhe rajoneve për kulturat bujqësore bimore**

Madhësia e Ekonomive Bujqësore	Prishtine	Mitrovica	Peje	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjakove	Gjithsej
1	824	478	383	380	211	256	402	2934
2	266	126	143	116	79	129	180	1039
3	246	112	151	145	100	111	166	1031
4	234	110	116	203	126	102	105	996
<b>Gjithsej</b>	<b>1570</b>	<b>826</b>	<b>793</b>	<b>844</b>	<b>516</b>	<b>598</b>	<b>853</b>	<b>6000</b>

**Tabela 3: Numri i ekonomive bujqësore të intervistuar sipas madhësisë së fermës dhe rajoneve për kulturat bujqësore bimore**

Madhësia e Ekonomive Bujqësore	Prishtine	Mitrovica	Peje	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjakove	Gjithsej
1	479	399	215	289	168	195	285	2030
2	140	92	79	88	61	97	135	692
3	133	85	68	105	76	57	112	636
4	126	77	45	130	85	51	43	557
<b>Gjithsej</b>	<b>878</b>	<b>653</b>	<b>407</b>	<b>612</b>	<b>390</b>	<b>400</b>	<b>575</b>	<b>3915</b>

#### 1.4. Përcaktimi i dizajnit të mostrës për Blegtori

Për anketën e blegtorisë janë përzgjedhur 3000 ekonomi bujqësore. Dizajni i mostrës një fazore, ndërsa variablat që janë përdorur për krijimin e stratave janë Regjioni ( 7 regjione) si dhe numri i klasave ( 4 klasa), gjithsej 28 strata.

**Tabela 4: Variablat dhe kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës te blegtoria**

Variablat	Kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës		
	Madhësia e klasës 1	Madhësia e klasës 2	Madhësia e klasës 3
Gjedhe	≥ 35 krer	≥ 20 krer	≥ 8 krer
Dele dhe Dhi	≥ 180 krer	≥ 50 krer	≥ 10 krer
Dele të mbarësuarra dhe Dhi të mbarësuarra	≥ 150 krer	≥ 50 krer	≥ 10 krer
Derra	≥ 30 krer	≥ 15 krer	≥ 8 krer
Shpezë	≥ 1000 krer	≥ 500 krer	≥ 250 krer
Pula (Brojler,zogj për majmeri)	≥ 500 krer	≥ 100 krer	≥ 50 krer
Koshere bletësh	≥ 100 koshere	≥ 50 koshere	≥ 20 koshere

Alokimi: Alokimi - Shpërndarja optimale është bërë duke përdorur Njësinë blegtorale (NjB/LSU) si ndryshore (variabel) ndihmëse për përcaktimin e numrit të ekonomive të përzgjedhura.

**Tabela 5: Numri i ekonomive bujqësore të zgjedhura ne mostër sipas madhësisë dhe rajoneve për sektorin e blegtorisë**

Madhësia e Ekonomive Bujqësore	Prishtine	Mitrovice	Peje	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjakove	Gjithsej
1	239	144	177	228	105	181	170	1244
2	38	17	26	25	13	24	21	164
3	61	28	44	36	21	35	37	262
4	318	161	163	234	142	142	170	1330
<b>Gjithsej</b>	<b>656</b>	<b>350</b>	<b>410</b>	<b>523</b>	<b>281</b>	<b>382</b>	<b>398</b>	<b>3000</b>

**Tabela 6: Numri i ekonomive bujqësore të intervistuarra sipas madhësisë së fermës dhe rajoneve për blegtorin**

Madhësia e Ekonomive Bujqësore	Prishtine	Mitrovice	Peje	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjakove	Gjithsej
1	133	102	88	164	78	127	105	797
2	22	14	15	18	9	17	9	104
3	28	23	26	24	18	23	21	163
4	112	110	65	105	62	69	72	595
<b>Gjithsej</b>	<b>295</b>	<b>249</b>	<b>194</b>	<b>311</b>	<b>167</b>	<b>236</b>	<b>207</b>	<b>1659</b>

### 1.5. Përcaktimi i dizajnit të mostrës për Anketen Ekonomike Bujqësore

Dizajni i mostrës për anketën ekonomike bujqësore është bazuar 7 regjione, tipet e fermave ( 2 tipe) dhe madhësia e klasave (4 klasa). Madhësia e mostrës për anketen ekonomike bujqësore ishte 800 EB (50% janë selektuar nga madhësia e klasës 1 dhe 50 % nga madhësia e klasës 2 dhe 3).

**Tabela 7: Variablat dhe kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës për anketën ekonomike bujqësore**

Variablat	Kriteri i përcaktimit të madhësisë së klasës		
	Madhësia e klasës 1	Madhësia e klasës 2	Madhësia e klasës 3
Toka e shfrytëzueshme bujqësore	≥ 2000 ari	≥ 1000 ari	≥ 200 ari
Gjedhe	≥ 35 krer	≥ 20 krer	≥ 8 krer
Dele dhe Dhi	≥ 180 krer	≥ 50 krer	≥ 10 krer
Dele të mbarësuara dhe Dhi të mbarësuara	≥ 150 krer	≥ 50 krer	≥ 10 krer
Derra	≥ 30 krer	≥ 15 krer	≥ 8 krer
Shpezë	≥ 1000 krer	≥ 500 krer	≥ 250 krer
Toka e punueshme ( arat)	≥ 1000 ari	≥ 500 ari	≥ 200 ari
Drithëra kokërr	≥ 850 ari	≥ 250 ari	≥ 120 ari
Bishtajore kokërr	≥ 150 ari	≥ 100 ari	≥ 20 ari
Bimë industriale	≥ 200 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Patate	≥ 800 ari	≥ 200 ari	≥ 50 ari
Vreshta	≥ 500 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Kultura të tjera rrënjore	≥ 300 ari	≥ 150 ari	≥ 50 ari
Pemishte	≥ 500 ari	≥ 100 ari	≥ 30 ari
Serra	≥ 100 m <sup>2</sup>	≥ 50 m <sup>2</sup>	≥ 20 m <sup>2</sup>
Koshere bletësh	≥ 100 koshere	≥ 50 koshere	≥ 20 koshere
Kulturave të përziera	≥ 300 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Pemët manore	≥ 100 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari
Lakra	≥ 250 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari
Speci	≥ 250 ari	≥ 100 ari	≥ 50 ari
Qepa	≥ 120 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari
Shalqiri dhe pjepr	≥ 150 ari	≥ 50 ari	≥ 20 ari

## Tipet (llojet) e fermave

Po ashtu janë marrë në konsideratë dy tipe të EB për stratifikim:

Tipi 1 - EB që mund të konsiderohen si "Ekonomi Blegtorale" sipas kategorive kryesore të blegtorisë. Kriteret në vijim të përdorura për EB të tipit 1 janë: gjedhe  $\geq 1$  ose dele  $\geq 4$  ose dhi  $\geq 4$  ose pulave  $\geq 50$ .

-Tipi 2 - Të gjitha EB e tjera përbëjnë tipin e dytë

-Alokimi: Shpërndarja optimale është bërë duke marrë për bazë TSHB si ndryshore (variabel) ndihmëse për përcaktimin e numrit të ekonomive të përzgjedhura.

**Tabela 8: Numri i ekonomive bujqësore të zgjedhura ne mostër sipas madhësisë dhe rajoneve për anketën ekonomike bujqësore**

Madhësia e Ekonomive Bujqësore	Prishtine	Mitrovica	Peje	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjakove	Gjithsej
1	101	67	59	40	33	29	71	400
2	51	25	28	23	16	25	31	199
3	48	22	30	29	20	21	31	201
<b>Gjithsej</b>	<b>200</b>	<b>114</b>	<b>117</b>	<b>92</b>	<b>69</b>	<b>75</b>	<b>133</b>	<b>800</b>

**Tabela 9: Numri i ekonomive bujqësore të intervistuar sipas madhësisë së fermës dhe rajoneve për ekonomike bujqësore**

Madhësia e Ekonomive Bujqësore	Prishtine	Mitrovica	Peje	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjakove	Gjithsej
1	53	56	32	30	27	24	49	271
2	33	18	14	19	15	17	16	132
3	25	10	17	19	15	15	17	118
<b>Gjithsej</b>	<b>111</b>	<b>84</b>	<b>63</b>	<b>68</b>	<b>57</b>	<b>56</b>	<b>82</b>	<b>521</b>

## 1.6. Definicionet

Anketa është kryer duke përdorur këto definicione :

**Ekonomia Bujqësore është një njësi e pavarur teknike dhe ekonomike e prodhimit, ku (1) ekonomia familjare ose (2) subjekti juridik kryen (3) veprimtarinë bujqësore si aktivitet kryesor ose dytësor, nën një menaxhim të vetëm dhe ku i përdorin mjetet e përbashkëta të prodhimit (tokën, blegtorinë, pajisjet, ndërtesat, etj.).**

**(1) Ekonomia Familjare** - nënkupton individin, bashkësinë familjare ose bashkësinë tjetër të personave (individëve), të cilët jetojnë së bashku dhe janë të vendosur plotësisht ose pjesërisht në një ekonomi familjare, si dhe furnizohen me gjëra ushqimore e gjëra të tjera të mundshme elementare për jetesë. Anëtarët e këtij grupi mund t'i bashkojnë të ardhurat e tyre në një masë më të madhe ose më të vogël.

**Ekonomi Familjare Bujqësore** - është një familje ose komunitet i njerëzve, ku anëtarët e saj janë të angazhuar në prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor ose dytësor, që kanë një menaxhim të vetëm,

duke përdorur mjetet e përbashkëta të prodhimit, të tilla si: tokën, makinat, ndërtesat, etj. Ekonomia Familjare Bujqësore mund të prodhojë produkte bujqësore për shitje, për konsum vetanak ose për të dyja.

**(2) Subjektet Juridike** - janë kooperativat bujqësore, bizneset individuale dhe format e tjera organizative me statusin e subjektit juridik, që janë regjistruar se kanë prodhimtari bujqësore si aktivitet të tyre kryesor; si dhe ndërmarrjet, institucionet dhe subjektet e tjera juridike, që janë regjistruar në një aktivitet tjetër, e të cilat kanë degë organizative ose pjesë të tjera organizative, ku kryhet prodhimi bujqësor.

**(3) Prodhimtaria bujqësore nënkupton:**

- Kultivimin e kulturave bujqësore (drithëra, patate, bishtajore të thara me kokërr, kultura industriale, bimë foragjere, perime, lule, bimë dekorative, farëra, fidane, pemë, rrush, kërpudha, etj.);
- Rritjen e bagëtisë, shpezëve dhe kafshëve të tjera (gjedhe, dele, dhi, derra, kuaj, gomarë, mushka, pula, bletë, lepuj, etj.); dhe
- Prodhimin e verës nga rrushi i prodhuar në Ekonominë Bujqësore.

**Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore** - i referohet sipërfaqes së përgjithshme të tokës së punueshme - arat, livadhet dhe kullosat, kulturat shumëvjeçare dhe kopshtet e përdorura nga EB-ja, pavarësisht nga lloji i zotërimit.

**Toka e punueshme - ara** - është sipërfaqja e tokës, e cila është kultivuar rregullisht me kultura të ndryshme bujqësore, ose është mbjellë me një renditje të caktuar të kulturave (sistemi i qarkullimit të kulturave). Sipërfaqja e tokës së punueshme e shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë vitit bujqësor. Normalisht, kulturat bimore ndryshojnë çdo vit, por ato po ashtu mund të jenë edhe shumëvjeçare. Për ta dalluar tokën e punueshme nga livadhet dhe kullosat është përdorur pragu pesëvjeçar. Kjo do të thotë se në qoftë se një parcelë e tokës është shfrytëzuar për të njëjtën kulturë për pesë vjet ose më shumë, pa largimin e kulturës bimore ose krijimin e një të reje, ajo nuk konsiderohet më si tokë me qarkullim bimor. Toka e punueshme përfshin drithërat, bishtajoret, bimët industriale, patatet, bimët foragjere, lulet dhe bimët dekorative, farërat dhe fidanët, perimet dhe kulturat e tjera të tokës së punueshme. Toka e punueshme gjithashtu përfshin edhe tokën djerrinë.

**Tokë djerrinë** – i referohet gjithë tokës së punueshme (arat) të përfshirë në qarkullim bimor, pavarësisht nëse punohet ose jo, por pa ndonjë qëllim për të prodhuar të korra gjatë vitit bujqësor. Karakteristikë themelore e tokës djerrinë është se ajo lihet një vit për qëllime ripërtëritjeje, normalisht gjatë gjithë vitit bujqësor. Toka djerrinë mund të jetë:

1. Tokë e zhveshur, në përgjithësi pa bimë,
2. Tokë me zhvillim të natyrshëm spontan, që mund të përdoret si ushqim për blegtorinë ose të plugohet,
3. Tokë e mbjellë ekskluzivisht për plehërim të gjelbër.

Përfshihen të gjitha sipërfaqet e tokës së punueshme, që mbahen në kushte të mira bujqësore dhe mjedisore, pa marrë parasysh nëse janë ose jo pjesë e qarkullimit bimor.

***Përrjashtohen, nëse këto sipërfaqe janë lënë jashtë prodhimit për më shumë se pesë vjet.***

**Kopshti** - është sipërfaqja e tokës për kultivimin e kulturave bujqësore, e dedikuar vetëm për konsum familjar (përrjashtojnë kultivimin e produkteve bujqësore për ushqim të kafshëve, p.sh. kungujt, misri për ushqimin e kafshëve, që kultivohen në kopsht, etj.), zakonisht e ndarë nga pjesa tjetër e tokës bujqësore.

**Prodhimtari bimore** - është konsideruar kultivimi i kulturave bujqësore (drithërat kokërr, bishtajoret kokërr (përfshirë bishtajoret për farë), kulturat industriale, patatet, kulturat e përziera, kulturat foragjere, rrënjojet,

lakrat foragjere dhe kungujt, lulet dhe bimët dekorative, farërat dhe fidanet, perimet, pemët, vreshtat dhe kërpudhat.

**Në mbajtjen e kafshëve** - është konsideruar mbajtja e bagëtitve, shpezëve dhe kafshëve të tjera (dhi, dele, derra, kuaj, gomarë, mushka, shpezë, bletët, lepujt, etj.). Në mbajtjen e kafshëve nuk konsiderohet mbajtja e peshkut dhe peshkimi.

**Sipërfaqja e korrur** - është sipërfaqja, në të cilën kulturat bujqësore janë korrur dhe është marrë prodhimi. Sipërfaqja e korrur mund të jetë më e vogël se sipërfaqja e mbjellë, në ato sipërfaqe ku kultura është dëmtuar.

**Gjithsej prodhimi** - është prodhimi, që është marrë në fund të korrjes/vjeljes, ose prodhimi që është ruajtur dhe pakësuar (dëmtuar) në sasi para korrjes, gjatë korrjes, transportit, etj. Prodhimi është i shprehur në kilogram – kg.

**Kulturat shumëvjeçare** – kultura, që nuk kultivohen në qarkullim bimor (rrotacion), përveç livadheve dhe kullosave, të cilat zënë tokën për një periudhë të gjatë dhe prodhimtarinë e kulturave gjatë disa viteve. Kulturat kryesore janë hardhitë e rrushit, pemët, shkurret dhe manoret shumëvjeçare për prodhimin e frutave, përveç dredhëzës. Pemishtet janë sipërfaqe bujqësore me pemë frutore, me distancë të caktuara ndërmjet rreshtave dhe ndërmjet trupave të pemëve.

**Plantacionet e pemëve** - janë sipërfaqe me pemë frutore, të mbjella në rreshta dhe me një distancë të caktuar ndërmjet rreshtave, që mundësojnë përdorimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, ku ndërmerren masat agroteknike.

**Pemishtet ekstensive** - janë sipërfaqe me pemë, gjysmë-intensive ose ekstensive të destinuar kryesisht për vetë-konsum. Këtu përfshihen pemët (trupat e shpërndarë) të vendosura në oborr, në ara, rreth gardhiqeve, afër rrugëve, në kopshte, etj. Sipërfaqja e pemishteve ekstensive (trupave të shpërndarë) është përfshirë vetëm në qoftë se kjo sipërfaqe nuk është e përfshirë të livadhet ose të ndonjë kategori tjetër e tokës.

**Plantacionet e vreshtave** - janë sipërfaqe me hardhi rrushi, me një distancë të caktuar ndërmjet rreshtave dhe ndërmjet hardhive, që mundësojnë përdorimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, si dhe aplikimin e masave agroteknike.

**Vreshtat** - janë sipërfaqe të tokës të kultivuara me hardhi të rrushit, të destinuar për prodhimin e rrushit.

**Fidanishtet** - janë sipërfaqe të tokës me bimë të reja – fidanë. Këtu janë përfshirë fidanishtet me fidanët e pemëve frutore, fidanët e hardhisë së rrushit, të bimëve dekorative dhe fidanishtet e fidanëve të pemëve pyjore.

Janë përfshirë fidanishtet, që prodhojnë fidanë pyjorë për shitje, qofshin brenda ose jashtë tokës pyjore, si dhe fidanishtet jokomerciale të fidanëve pyjorë, që prodhohen për nevojat e vetë EB-së, nëse fidanët janë rritur jashtë tokës pyjore. Fidanishtet për nevojat e vetë EB-së, që janë të rritura brenda tokës pyjore janë të përfshira në kategorinë e tokës pyjore.

**Livadhet** - janë toka të përdorura (për pesë vjet ose më shumë) për kultivimin e barojave të ndryshme, nëpërmjet kultivimit (mbjelljes) ose në mënyrë natyrale (vetë-mbjelljes) dhe nuk janë përfshirë në qarkullimin e kulturave në Ekonominë Bujqësore. Livadhet përdoren për kositje për sanë, ose për kullotje. Këtu përfshihen të gjitha sipërfaqet e livadheve të shfrytëzuara gjatë vitit referues.

**Kullotat** - janë sipërfaqet e tokave të përdorur për kullotjen e bagëtisë. Bëjnë pjesë vetëm sipërfaqet e kullotave, që janë përdorur për kullotjen e bagëtive, të paktën një herë gjatë vitit.

**Toka e përbashkët** - është toka, që nuk i takon drejtpërsëdrejti EB-së, por që në të aplikohen të drejtat e përbashkëta. Ajo mund të përbëhet nga kullotat, livadhet ose toka tjetër.

Në përgjithësi, toka e përbashkët është toka e shfrytëzuar bujqësore në pronësi të një autoriteti publik (shtetëror, komunal) mbi të cilën një person mund t'i ushtrojë të drejtat e përbashkëta. Këto të drejta ushtrohen në përgjithësi në mënyrë të përbashkët me të tjerët.

### Periudhat referuese

- Periudha referuese për shfrytëzimin e tokës është viti i bujqësor (31 tetor 2021 – 1 nëntor 2022).
- Periudha referuese për numrin e kafshëve shpezëve dhe bletëve është 1 nëntori 2022, ndërsa për produktet blegtorale, therjet e kafshëve dhe shpezëve, shitjet e kafshëve, shpezëve dhe bletëve është viti bujqësor (31 tetor 2021 – 1 nëntor 2022).

### 1.7. Procedura në terren

Metoda e grumbullimit e të dhënave është realizuar duke përdorur metodën CAPI (Computer-assisted personal interviewing - Intervistë me ndihmën e kompjuterit), përdorim të tabletit dhe aplikacioni elektronik për grumbullimin e të dhënave i cili është dizajnuar me “survey solution”, intervista është kryer ballë për ballë anketues – fermer/e sipas pyetësorit (Aneks 1).

Anketa është kryer nga anketuesit e angazhuar përmes marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të ASK-së me Agjencin e Punësimit të Republikës së Kosovës (ARPK). Anketuesit paraprakisht janë trajnuar për plotësimin e pyetësorit dhe për realizimin e anketës. Trajnimi ka zgjatur dy ditë dhe anketuesit janë ndihmuar në vazhdimësi gjatë fazës së grumbullimit të të dhënave.

Menaxhimi dhe kontrollimi i të dhënave është kryer në dy nivele: (i) kontrollimi dhe monitorimi gjatë grumbullimit të dhënave në teren nga mbikëqyrësit; dhe (ii) kontrollimi logjik dhe përpunimi i të dhënave nga personeli i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit në zyrën qendrore të ASK-së.



## 2. Shfrytëzimi i tokës bujqësore


Në këtë kapitull janë paraqitur të dhënat: për tokën bujqësore, sipas kategorive të shfrytëzimit: tokë e punueshme - ara, livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët), kulturat shumëvjeçare<sup>1</sup> dhe kopshtet e përdorura nga EB-ja, pavarësisht nga lloji i zotërimit. Nuk janë përfshirë të dhënat për tokën pyjore, tokën bujqësore të pa përdorur dhe tokën jo bujqësore.

**Tabela 1: Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore**

Shfrytëzimi i tokës bujqësore	Sipërfaqja (ha)
Tokë e punueshme - ara	188 404,61
- Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	8 584,37
- Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	583,03
Kopësht	1 079,94
Plantacione të pemëve	10 377,25
Plantacione të vreshtave <sup>2</sup>	3 472,34
Fidanishte	150,25
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	216 998,06
<b>Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore</b>	<b>420 482,46</b>

Sipas të dhënave gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte 420 482,46 hektarë, pjesa më e madhe i përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) 216 998,06 ha ose (51,6 %), ndërsa tokë e punueshme – ara 188 404,61 ha ose (44,8 %), nga të cilat perime në fushë të hapur dhe perimet në serra janë përfshirë në këtë kategori të tokës.

**Grafiku 1: Struktura e sipërfaqes së shfrytëzuar e tokës bujqësor**



<sup>1</sup> Në kulturat shumëvjeçare janë përfshirë këto kategori: plantacionet e pemëve, plantacionet e vreshtave dhe fidanishtet.

<sup>2</sup> Burim i të dhënave për plantacionet e vreshtave është MBPZHR.

## 2.1 Prodhimtaria bujqësore

Me këtë anketë janë mbledhur të dhëna mbi sipërfaqet e tokës bujqësore, sipas kategorive të shfrytëzimit, sipërfaqes së mbjellë (në hektarë), prodhimit (në ton) dhe rendimentit (ton për hektar).


Toka e punueshme – ara, përfshin këto kategori: drithërat, bishtajoret, bimët industriale, patatet, bimët foragjere, perimet dhe kulturat e tjera. Toka e punueshme, gjithashtu përfshin edhe tokën djerrinë<sup>3</sup>.

**Tabela 2: Kulturat bujqësore në tokë të punueshme - ara, prodhimi dhe rendimenti**

Kulturat	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (ton)	Rendimenti (t/ha)
<b>Drithëra për kokërr</b>	<b>124 617,49</b>		
Grurë	79 984,16	330 913,02	4,1
Misër	39 797,05	175 226,19	4,4
Elb dhe elb birre	2 066,50	5 881,88	2,8
Thekër	567,29	1 491,74	2,6
Tërshër	2 044,53	4 715,18	2,3
Drithëra të tjera kokërr	157,97	495,95	3,1
<b>Bishtajoret për kokërr (thatë)</b>	<b>3 052,40</b>		
Fasule	2 941,02	5 596,78	1,9
Bizele kokërr	67,69	153,90	2,3
Bishtajorë të tjera	43,69	116,07	2,7
<b>Kulturat industriale</b>	<b>886,90</b>	<b>1 179,59</b>	<b>1,3</b>
<b>Patate</b>	<b>3 884,43</b>	<b>75 500,40</b>	<b>19,4</b>
<b>Perime (në fushë të hapur dhe serra)</b>	<b>9 167,40</b>		
<b>Kulturat foragjere</b>	<b>37 614,61</b>		
Jonxhë	18 358,66	85 044,20	4,6
Tëfil	937,72	3 702,67	3,9
Perzierje e barit	9 315,79	29 542,46	3,2
Urov	610,22	2 709,71	4,4
Misër i gjelbër	7 080,36	120 088,32	17,0
Grurë i gjelbër	415,19	3 205,39	7,7
Tërshër e gjelbër	755,89	5 415,38	7,2
Elb i gjelbër	56,70	205,42	3,6
Thekër i gjelbërt	18,96	176,61	9,3
Foragjere të tjera të gjelbëra (grashinë)	65,12	273,63	4,2
<b>Rënjorë, lakër foragjere dhe kunguj</b>	<b>2 701,02</b>		
Lakër, pangjar foragjere	72,66	1 215,27	16,7
Kungull	2 628,36	22 551,13	8,6
<b>Lulet dhe bimët dekorative</b>	<b>24,59</b>	-	-
<b>Fara dhe fidane të perimeve</b>	<b>26,19</b>	-	-
<b>Kultura të tjera</b>	<b>19,49</b>	<b>87,56</b>	<b>4,5</b>
<b>Tokë djerrinë</b>	<b>6 410,09</b>	-	-


<sup>3</sup> Në tokën djerrinë përfshihen të gjitha sipërfaqet e tokës së punueshme, që mbahen në kushte të mira bujqësore (qarkullimit bimor) ose jo. Në këtë kategori nuk përfshihen sipërfaqet e lëna jashtë prodhimit për më shumë se pesë vjet.

**Grafiku 2: Struktura e sipërfaqeve të tokës së punueshme - arave me kultura bujqësore**




Në tokën e punueshme - ara pjesa më e madhe është me drithëra kokërr. Drithërat kokërr janë mbjellë në 124 617,49 ha ose (66,1%) të sipërfaqes së tokës së punueshme, grupi i dytë për nga madhësia e sipërfaqes së kulturave në tokën e punueshme - ara janë kulturat foragjere me 37 614,61 ha ose (20,0 %) të sipërfaqes së tokës së punueshme.

**Grafiku 3: Struktura e sipërfaqeve me drithëra për kokërr**




Kultura më e rëndësishme është gruri me sipërfaqe 79 984,16 ha ose (64,2%), pasuar nga misri 39 797,05 ha ose (31,9 %) të sipërfaqes së tokës së punueshme me drithëra.

**Grafiku 4: Struktura e sipërfaqeve me bishtajore**



**Grafiku 5: Struktura e sipërfaqeve me foragjere dhe drithëra të gjelbër**




## 2.2 Perimet

Gjithsej sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur, serra dhe kopshte ishte 10 247,34 ha.

**Tabela 3: Perime në tokë të punueshme - ara, sipërfaqja, prodhimi në fushë të hapur, serra, kopshte**

Kultura	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (ton)	Rendimenti (t/ha)
<b>Perime</b>	<b>10 247,34</b>		
Speca	3 153,72	55 352,62	17,6
Domate	805,09	20 205,91	25,1
Tranguj	314,83	8 972,96	28,5
Qepë	1 376,16	19 190,27	13,9
Hudhër	270,27	1 593,70	5,9
Shalqi	1 315,98	27 489,89	20,9
Pjepër	328,66	4 466,80	13,6
Lakër	937,19	25 545,88	27,3
Lulelakër	56,78	953,52	16,8
Spinaq	162,40	1 556,53	9,6
Sallatë	84,01	708,04	8,4
Kungull misiri (vidim)	926,43	21 975,18	23,7
Majdanoz	14,10	150,76	10,7
Presh (purri)	79,72	1 464,99	18,4
Patëllgjan i zi	8,92	175,06	19,6
Rillkë	4,40	49,77	11,3
Pangjar i kuq	8,73	67,40	7,7
Karrotë	132,34	1 770,38	13,4
Dredhëz	241,86	1 685,51	7,0
Perime të tjera	25,74	193,77	7,5

**Grafiku 6: Struktura e sipërfaqeve me perime në fushë të hapur, serra dhe kopshte**




Ndër perimet më të rëndësishme janë: specat të cilët janë mbjellë në 3 153,72 ha, pastaj kultura e qepës renditet e dyta me 1 376,16 ha, shalqiri me sipërfaqe të mbjellur 1 315,98 ha, lakra me sipërfaqe të mbjellur në 937,19 ha, domate me sipërfaqe të mbjellur 805,09 ha dhe perime të tjera 2 659,20 ha.

Tabela 4: Sipërfaqja dhe prodhimi i perimeve në fushë të hapur, serra dhe kopshte

Kultura	Në tokën e punueshme - ara								
